

31.07.2025

AIDA

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2025

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundim it të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
01	20.01.2025	Aplikimin e subjektit aplikues [redacted] pranë AIDA. Aneksin 1,2,3 te vendimit nr. 23, date 30.12.2024 “Për miratimin e statusit investim/investitor strategjik procedurë e veçantë për projektin e investimit “Resort Turistik – ishulli i Sazanit” me subjekt aplikues [redacted]	21.01.2025	1. Aplikimin e subjektit aplikues “ [redacted] ” pranë AIDA. A janë identifikuar përfituesit fundorë të kompanisë [redacted] ” dhe nëse po, cilët janë ata? Aplikimi për përfitimin e statusit strategjik është nga kryer nga kompania [redacted], subjekt i së drejtës amerikane dhe është trajtuar nga AIDA duke u mbështetur në të gjitha kriteret ligjore që parashikon legjislacioni për investimet strategjike, përkatësisht VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit”. Vetë AIDA, në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, Neni 13/dh, parashikon se subjekti aplikues, përveç të tjerash, dorëzon tek AIDA ‘autorizimin mbi dakordësinë e investitorit për publikimin e detajeve të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej	E plotë	Nuk ka

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		[REDACTED] A janë identifikuar përfituesit fundorë të kompanisë “[REDACTED]” dhe nëse po, cilët janë ata?	tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë’. Kjo dispozitë e veçantë zërthehet më gjerë në VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 ‘Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike’ ku në Kreun I, pika 4/gj, parashikohet shprehimisht se: ‘Dokumentacioni që dorëzohet duhet të përfshijë detyrimisht pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë, të përcaktuara, shprehimisht, nga subjekti i interesuar’. Për sa më lart, në dosjen e administruar përfshihet deklarata e subjektit aplikues mbi të dhënat apo dokumentacionin në dosje që përcaktohet shprehimisht nga subjekti si konfidencial. Në të tilla kushte, në pamundësi për të cenuar marrëveshjen me subjektin aplikues, por për të ezauruar çdo shqetësim tuajin lidhur me procedurën e ndjekur, ne mbetemi në dispozicionin Tuaj, kurdo që ju e keni të mundur të vini pranë zyrave të AIDA, për të konsultuar dosjen aplikuese ashtu si dhe për të marrë të gjitha shpjegimet e nevojshme mbi çdo dokumentacion të dorëzuar dhe shqyrtuar të projekteve të investimit. 2. Aneksin 1,2,3 te vendimit nr. 23, date 30.12.2024 “Për miratimin e statusit investim/investitor strategjik procedurë e veçantë për projektin e investimit “Resort Turistik – ishulli i Sazanit” me subjekt aplikues Atlantic Incubation Partners LLC”, shoqëri e së drejtës amerikane me nr. Identifikimi (ein) 92-3329707.		
--	--	---	--	--	--

				Bashkelidhur ketij emaili lutem gjeni vendimin e KIS se bashku me Anekset përkatëse.		
02	27.01.2025	[REDAKTUAR], në bazë të ligjit nr. 190 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, neni 3, dhe ju lutet institucionit tuaj për vënie në dispozicion dokumentet zyrtar/informacion në lidhje me projektin strategjik të propozuar nga kompania [REDAKTUAR] për zhvillim turistik të zonës sw Sazanit dhe Zvernecit. Më konkretisht: 1- Një kopje të aplikimit të bërë në Agjencinë Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për projektin turistik në ishullin e Sazanit i propozuar nga kompania [REDAKTUAR]	28.01.2025	Ne vijim te kerkeses suaj ju informojme si me poshte vijon: Aplikimi për përfitimin e statusit strategjik është nga kryer duke u mbështetur në të gjitha kriteret ligjore që parashikon legjislacioni për investimet strategjike, përkatësisht VKM Nr. 1026, 3roc 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit”. Vetë AIDA, në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 55/2015, I ndryshuar, Neni 13/dh, parashikon se subjekti aplikues, përveç të tjerash, dorëzon tek AIDA ‘autorizimin mbi dakordësinë e investitorit për publikimin e detajeve të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë’. Kjo dispozitë e veçantë zërthehet më gjerë në VKM Nr. 1026, 3roc 16.12.2015 ‘Për vlerësimin dokumentacionit të investimeve strategjike’ ku në Kreun I, pika 4/gj, parashikohet shprehimisht se: ‘Dokumentacioni që dorëzohet duhet të përfshijë detyrimisht pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë, të përcaktuara, shprehimisht, nga subjekti i interesuar’. Për sa më lart, në dosjen e administruar përfshihet deklarata e subjektit aplikues mbi të dhënat apo dokumentacionin në dosje që përcaktohet shprehimisht nga subjekti si konfidencial. Në të tilla	E plotë	Nuk ka

		2-Një kopje të planit të biznesit të investimit, për projektin turistik në ishullin e Sazanit i propozuar nga kompania [REDACTED] 3-Një kopje të identitetit të investitorit dhe i partnerëve të tij për projektin turistik në ishullin e Sazanit i propozuar nga kompania [REDACTED] 4-Një kopje të dokumentit ku bëhet përshkrimi i detajuar i projektit të investimit në ishullin e Sazanit i propozuar nga kompania [REDACTED] 5-Një kopje të dokumentit ku bëhet përshkrim i detajuar i punëve që do të realizohen dhe shërbimeve që do të ofrohen sipas projektit investues në ishullin e Sazanit i propozuar nga		kushte, në pamundësi për të cenuar marrëveshjen me subjektin aplikues, por për të ezauruar çdo shqetësim tuajin lidhur me procedurën e ndjekur, ne mbetemi në dispozicionin Tuaj, kurdo që ju e keni të mundur të vini pranë zyrave të AIDA, për të konsultuar dosjen aplikuese ashtu si dhe për të marrë të gjitha shpjegimet e nevojshme mbi çdo dokumentacion të dorëzuar dhe shqyrtuar të projekteve të investimit.		
--	--	---	--	--	--	--

		kompania [REDACTED] 6-Një kopje të dokumentit ku tregohet përshkrimi i karakteristikave të investimit që i referohen, specifikisht, zhvillimit të teknologjive të reja dhe mbrojtjes së mjedisit për projektin turistik në ishullin e Sazanit i propozuar nga kompania [REDACTED] 7-Një kopje të dokumentit që tregon analizën e detajuar mbi impaktin që punët dhe shërbimet e projektit mund të kenë mbi mjedisin dhe në planet urbanistike projekti turistik në ishullin e Sazanit i propozuar nga kompania [REDACTED]. 8-Një koje të dokumentit që tregon analizë e detajuar të impaktit ekonomik dhe social të pritshëm nga realizimi i				
--	--	--	--	--	--	--

		projektit investues në ishullin e Sazanit i propozuar nga kompania [REDACTED] 9- Një kopje të dokumentit të analizës së përfitimeve me interes publik që parashikohet të ketë shteti shqiptar nga realizimi i projektit në ishullin e Sazanit i propozuar nga kompania [REDACTED]				
3.	05.02.2025	Kërkoj informacion nga institucioni juaj nëse subjekti "[REDACTED]", apo ndonjë SUBJEKT tjetër, ka paraqitur pranë jush kërkesë/aplikim (si investitor propozues i projektit/Subjekt investues), apo ka përfituar statusin investitor/investim strategjik (të çfarëdo procedure), për pasurinë me Nr. 6/229; 6/815; 6/816,	05.02.2025	Ne vijim te kërkeses suaj ju informojme si me poshte vijon: AIDA është struktura administrative kompetente për dhenien e shërbimeve per investitorin ne nje "dritare unike" per investitoret/projektet, te cilet aplikojne dhe kërkojne te perfi tojne statusin "Investim/investitor strategjik, procedure e asistuar/e veçante". Ne perputhje me parashikimet e ligjit nr. 55/2015, "Per investimet strategjike në RSH" I ndryshuar, çdosubjekt investues I interesuar, person juridik privat, vendas ose I huaj, ka te drejten per te kerkuarperfshirjen e nje projekti investues ne procedurat administrative te investimeve strategjike, me qellim marrjen e statusit "Investim/investitor strategjik, procedure e asistuar" apo "Investim/investitorstrategjik, 6rocedure e veçante". Subjektet e interesuara, te cilat kerkojnë perfshirjen e projekteve tetyre investuese ne	E plotë	Nuk ka

		Zona Kadastrale 8350, Tiranë? Nëse është paraqitur një kërkesë/aplikim i tillë dëshiroj të pajisem me një kopje të kërkesë/aplikimit dhe vendimit tuaj për rastin.		procedurat administrative te investimeve strategjike, paraqesin, per kete qellim, nje kerkese me shkrim prane AIDA, se bashku me dokumentacionin perkates bazuar ne kriteret eparashikuara ne ligj Nr. 55/2015, I ndryshuar dhe VKM Nr. 1026, date 16.12.2015 “Per vleresimin edokumentacionit”. Prane AIDA, me date 27.12.2023 eshte paraqitur vetem nje shprehje interesi per perfitimin e statusit “investim/investitor strategjik, procedure e vecante” [REDACTED] AIDA ne rolin e agjentit asistues, ne zbatim te detyrave te percaktuara ne kete ligj, ndjek te gjitha procedurat administrative te parashikuara qe nga momenti I paraqitjes se kerkeses per perfshirjen ne procedurat administrative per përfi timin e statusit “Investim/investitor strategjik” deri në perfundimin ete gjitha procedurave administrative, te parashikuara nga ky ligj. Duke qene se, per kete rast ka vetem nje shprehje interesi dhe subjekti nuk ka dorezuar dokumentacionin e plote per aplikim, bazuar ne kriteret e parashikuara ne ligj Nr. 55/2015, I ndryshuadhe VKM Nr. 1026, date 16.12.2015 “Per vleresimin e dokumentacionit” nuk eshte vijuar me trajtim te metejshem te saj dhe as nuk eshte proceduar me procesin e vleresimit. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera nuk rezulton te kete shprehje te tjera interesi nga subjekte te tjere lidhur me kete gjurme.		
4.	02.03.2025	Koston financiare te samitit te pare, te dyte e te trete te	3.5.2025	AIDA nuk eshte institucioni kompetent qe ka organizuar Samitet e Diaspores. Keto aktivitete jane organizuar nga Agjencia Kombetare e	E plotë	Nuk ka

		diaspores, veç e veç per secikin samit. Aktivitetet e organizuara per secilin samit. Pjesmarresit, emrat e personave publik, qeveritareve dhe emrat e pjesmarresve te administrates publike pjese e ketyre samiteve, listen e pjesmarresve te ftuar, perkatesisht edhe funksionet e tyre publike nese kane. Ministrine pergjegjese per organizimin e ketyre aktivitetve. Bazen ligjore ku jane mbeshtetur aktivitetet, financimet publike per keto aktivitete.		Diaspores (AKD), e cila ka ne mision zhvillimin dhe thellimin e bashkepunimit institucional me diasporen. AIDA, ne kuader te misionit te saj synon rritjen e konkurrueshmerise per kompanite e vogla e te mesme, forcimin e potencialit eksportues të vendit, si dhe promovimin dhe mbeshtetjen e investimeve te huaja direkte në Shqiperi. AIDA ka marre pjese si e ftuar ne panele ne eventet e organizuara nga AKD duke ofruar mbeshtetjen per investitoret potenciale nga diaspora per te investuar ne Shqiperi. Per sa me siper, lutemi te drejtoheni Agjencise Kombetare te Diaspores, per te marre informacionin e kerkuar		
4.1	05.03.2025	Kerkoj informacion per pasqyren e shpenzimeve te institucionit tuaj per vitin 2023, 2022 (dokumentin zyrtar me firme e me vule ose pdf). Kalendarin e aktiviteve dhe	07.03.2025	Ne vijim te komunikimeve te meposhtme bashkelidhur gjeni Model Kerkesen per Informacion e hartuar nga Zyra e Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e cila ne reference te ligjit Nr.119/2014 duhet te shoqerohet edhe me mjen e idenfikimit. Ne lidhje me informacionin e kerkuar lutemi te konsultoni webin e AIDA sipas linqeve me poshte per te aksesuar te gjithë informacionin e kerkuar:	E plotë	Nuk ka

		shpenzimeve per to per dy vitet e sipershenuara. Struktura e institucionit tuaj. Rregulloren e brendshme te institucionit tuaj. Numrat e protokolleve te te gjitha emailkeve qe kam derguar deri tani, bashke me kete email ne nje dokument me firme e vule.		https://aida.gov.al/aida/baza-ligjore-aida/ https://aida.gov.al/aida/buxhem-dhe-audim/ https://aida.gov.al/aida/struktura-organizave/ https://aida.gov.al/aida/programi-i-transparences/ Per cdo pyetje apo paqartesi mbetemi ne dispozicionin tuaj.		
	07.03.2025	Me webin jam konsultuar dhe informacioni qe ju kam kerkuar nuk ndodhet ne web, pra duhet ta nxirrni ju e te ma jepni. Kaeten e identitetit jua kam derguar. Kerkesa per informacion nuk ka nevojë per format te gazshem si modeli qe me keni derguar pasi edhe nga emaili mund te behet pa asnje problem	10.03.2025	Ne vazhdimesi te komunikimeve tona lutemi gjeni ne link me poshte informacionin e kerkuar. https://www.filemail.com/d/pmmhnuwnqlktdra Mbetemi ne dispozicion per cdo pyetje.		

		juridiko burokratik. Ju lutem me ktheni pergjigje per te gjitha emailket veç e veç. Me dergoni te listuara emaillet qe ju kam derguar me numrat e protokollit perkates. Jam ne pritje te perfundimit te afatit te kthimit te pergjigjeve tuaja deri ne mbylljen e afatit 5 dite pune, ne vazhdim do dergoj anlese tek komisioneri per te drejten e informimit per mungese informacioni nga ana juaj, pengese ne fhenien e informacionit edhe vonese!				
5.	04.04.2024	Bashkëlidhur këtij email-i, do të gjeni kërkesën tonë për informacion në lidhje me statusin e investitoritstrategjik. Kemi kërkuar vënien në dispozicion të informacionit dhe dokumentacionit shkresor	07.04.2025	Ne vijim te kerkeses suaj ju bejme me dije se Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) ne baze dhe zbatimte ligj 55/2015, i ndryshuar dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij nuk ka miratuar asnje projekt propozimme statusin investim/investitor strategjik, procedure e vecante. Per lehtesine tuaj te gjitha vendimet e KISper cdo kerkese te miratuar apo mospranuar nga KIS gjenden ne link me poshte: https://aida.gov.al/investimet-ne-shqiperi/strategjike/komiteti-investimeve-strategjike-kis/	E plotë	Nuk ka

		qëkonfirmon nëse shoqëria [REDACTED] dhe [REDACTED] kanë fituar statusin e investitoritstrategjik për realizimin e projektit [REDACTED], i cili do të zhvillohet në fshatin Baks Rrjoll, Velipojë.		Per cdo paqartesi mbetemi ne dispozicion.		
6.	09.04.2025	A ka projekte me investim strategjik nga zona e Velipojës në Shëngjin? Nëse po, mi listo dhe në cilën fazë zhvillimi janë?	02.05.2025	Ne vijim te kerkeses suaj ju informojme si me poshte vijon: Te gjitha Vendimet e Komitetit te Investimeve Strategjike (KIS) perfishire dhe zonat e kerkuara nga ana juaj mund ti aksesoni prane webit te AIDA ne link: https://aida.gov.al/investimet-ne-shqiperi/strategjike/komiteti-investimeve-strategjike-kis/ Per lehtesine tuaj, referuar vendimeve te marra nga KIS ne zonen e synuar, i vetmi projekt me status aktiv eshte projekti [REDACTED] me subjekt aplikues [REDACTED], i cili eshte pajisur me leje zhvillimi dhe ndertimi dhe ka filluar zbatimin tij. Per cdo sqarim te nevojshem, mbetemi ne dispozicion.	E plotë	Nuk ka
7.	11.04.2025	Në kuadër të një studimi të realizuar nga organizata Eco	24.04.2024	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) është struktura administrative kompetente për dhënien e shërbimeve për	E plotë	Nuk ka

		Albania në funksion të një studimi mbi zhvillimet infrastrukturore dhe investimet në Deltën e Vjosës, Bashkitë Vlorë, Fier dhe Selenicë, ju drejtohem me kërkesën për informacion të mëposhtëm lidhur me verpimtaritë e KIS në përputhje me të drejtën për informim dhe nevojën për transparencë institucionale: 1. Lista e projekteve të cilave u është dhënë statusi strategjik që nga vitit 2016 deri më sot 2. Procedurat dhe kriteret mbi të cilat KIS bazon vlerësimin për dhënien e statusit të investimit strategjik; 3. Numrin e projekteve që kanë ndikuar osë përfshijnë zona të mbrojtura, lumenj apo resurse natyrore me rëndësi mjedisore.	investitorët të cilat aplikojnë dhe kërkojnë të përfitojnë statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, të cilët trajtohen në zbatim të Ligjit nr.55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij, përkatësisht edhe VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”. Ky ligj zbatohet për të gjitha investimet strategjike, që përzgjidhen si të tilla në bazë të kriterëve e sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe në ata sektorë ekonomikë të përcaktuar shprehimisht nga ky ligj si sektorë të investimeve strategjike, më konkretisht në nenin 8 të ligj Nr. 55/2015, i ndryshuar dhe Kreut II të VKM-së së sipërcituar. Në bashkëlidhje të kësaj shkrese mund të gjeni listën e projekteve të investimit që kanë përfituar statusin investim/investitor strategjik përgjatë periudhës 2016 – 2024. Informacion mbi vendimet e Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) mund ta gjeni dhe në faqen e webit https://aida.gov.al/investimet-ne-shqiperi/strategjike/komiteti-investimeve-strategjike-kis/ Për sa i përket, kërkësës suaj së tretë sipas së cilës kërkoni numrin e projekteve që kanë ndikuar apo përfshijnë zona të mbrojtura, lumenj, apo resurse natyrore me rëndësi mjedisore ju sqarojmë se “Vendimi i KIS, në		
--	--	--	--	--	--

		vazhdim pasi nga kërkimet tona në regjistër del si pronar përfitues Pëllumb Kallaba. Në komunikimin zyrtar me Qendrën Kombëtare të Biznesit kemi siguruar informacion zyrtar se QKB-ja ka vendosur penalitete ndaj këtij subjekti pasi nuk ka siguruar dokumentet për të konfirmuar pronësinë. Ndërkohë në ekstraktin historik të subjektit [REDACTED] është bërë transferimi i aksioneve nga [REDACTED] Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, ne	strategjik për zhvillimin e vendit dhe me interes publik, i cili klasifikohet si i tillë që nga momenti i nismës për të hartuar projektin nga promovuesi i projektit deri në momentin e përfuturimit të statusit “Investim/investitor strategjik”. Në referencë të Nenit 14 të ligj Nr. 55/2015 i ndryshuar cdo subjekt investues i interesuar, vendas/i huaj, sipas sektorit të projektit investues ka të drejtën për të kërkuar përfshirjen e një projekti investues në procedurat administrative të investimeve strategjike, me qëllim marrjen e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”. Me tej kjo dispozitë sqaron se subjekti duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim pranë AIDA, e cila, pasi vlerëson paraprakisht potencialin strategjik të një projekti, bazuar në nenin 5, të këtij ligji, asiston subjektin për mbledhjen e informacionit me të dhënat e karakterit teknik, ligjor, administrativ etj., të nevojshme për hartimin, përgatitjen dhe zbatimin e investimit. Gjithashtu, në pikën 8 të Kreut II të VKM Nr.1024, datë 16.12.2015 parashikohet se subjekti aplikues duhet të paraqesë, kërkesën e cila duhet të shoqërohet me Planin e Biznesit të investimit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm: a) Identiteti i investitorit dhe i partnerëve të tij; b) Përshkrimi i detajuar i projektit të investimit; c) Përshkrimi i detajuar i punëve që do të realizohen dhe i shërbimeve që do të ofrohen sipas projektit investues;	
--	--	---	--	--

		kërkojmë si informacion: 1. Si e keni shpallur fitues subjektin “ [REDACTED] ” përfitues të Statusit “Projekt me Potencial Strategjik” për projektin e investimit [REDACTED] ” kur nuk ka pronarin përfitues të regjistruar me dokumente sipas ligjit për Regjistrimin e Pronarëve Përfitues? 2. Sipas Vendimit nr. 1024, datë 16.12.2015 për miratimin e projekteve me statusin “PROJEKT ME POTENCIAL STRATEGJIK” pika 8, në rastet kur propozimi për përfitimin e statusit “projekt me potencial strategjik” paraqitet nga investitori propozues i projektit, kërkesa duhet të shoqërohet me planin	ç) Analiza e detajuar e afateve kohore që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e realizimit të tij; d) Përshkrimi i karakteristikave të investimit që i referohen specifikisht zhvillimit të teknologjive të reja dhe mbrojtjes së mjedisit; dh) Analiza financiare e të gjithë projektit investues, si dhe analiza e shpenzimeve financiare që do të nevojiten për realizimin e çdo faze të projektit; e) Analiza e detajuar për ndikimin që mund të kenë mbi mjedisin dhe në planet urbanistike punët dhe shërbimet e projektit; ë) Analiza e detajuar e ndikimit ekonomik dhe social, të pritshëm nga realizimi i projektit investues; f) Analiza e përfitimeve me interes publik që parashikohet të ketë shteti shqiptar nga realizimi I projektit. Për sa më sipër, legjislacioni në këtë fazë të procesit nuk parashikon detyrimin për të plotësuar kushtet financiare, pasi jemi në kushtet e “projektit me potencial strategjik” ku në thelb objektivi i procesit vlerësues është projekti dhe jo subjekti aplikues. Referuar rastit konkret: • [REDACTED] dhe i jep 6 muaj kohë subjektit për të aplikuar për status përfundimtar. Gjatë kësaj periudhe subjekti do duhet të realizonte studime dhe matje të nevojshme në terren duke u asistuar nga institucionet kompetente të	
--	--	--	---	--

		e biznesit të investimit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni sipas pikë “a”, identiteti i investitorit dhe i partnerëve të tij; a) Në këtë rast, si e keni shpallur fitues subjektin [REDACTED] përfitues të Statusit “Projekt me Potencial Strategjik” kur nuk keni regjistrimin e pronarit përfitues? b) Në këtë rast keni shpallur [REDACTED] si investitor përfitues të Statusit “Projekt me Potencial Strategjik”, çfarë projekti ka dorëzuar [REDACTED] që të tregojë që i plotëson kushtet dhe garancitë për investimin 50 milionë euro? c) Në të dyja rastet, kompania [REDACTED] nuk ka injektuar kapital me vlerë të lartë në Shqipëri, cilat janë garancitë që do	përfshira. Nëpërmjet këtij vendimi ilustron lehtësisht që projekti i investimit ndodhej në fazat e fillestare të krijimit të tij. • [REDACTED] sërish për një periudhë shtesë 6 mujore. Vendimi ilustron qartësisht se subjekti realizoi disa prej anagazhimeve të ndërmarra për aplikim për status përfundimtar por koha rezultoi e pamjaftueshme pasi pati një mospërputhje të ngastrave të kërkuara nga subjekti për të bërë matjet e nevojshme teknike në terren dhe kontratës së qirasë të lidhur ndërmjet subjektit dhe Bashkisë Tropojë. Në përfundim të afatit të vënë nga KIS subjekti do duhet të dorëzonte pranë AIDA dokumentacionin e plotë në referencë të pikës 1 të Kreut III të VKM Nr. 1024, datë 16.12.2015 ku sipas të cilës “Me marrjen e statusit “projekt me potencial strategjik” investitori ka të drejtë të përfitojë asistencën e mëtejshme të Agjencisë për përfitimin e statusit përfundimtar “Investim /investitor strategjik, procedurë e asistuar” apo “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”. Në këtë rast, subjekti është i detyruar të paraqesë garancitë financiare të projektit dhe justifikojë kapacitetin financiar. Aktualisht, ju bëjmë me dije se subjekti nuk ka dorëzuar ende pranë AIDA kërkesë dhe dokumentacion për status përfundimtar. Për sa i takon dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti në kohën e aplikimit	
--	--	--	---	--

		të investohen 50 milionë euro për këtë projekt? Ju lutemi, na vendosni kopje të dokumenteve me të dhënat personale të anonimizuara, ku shpalosen garancitë për investimin e projektit.		sjellim në vëmendjen tuaj se AIDA ka vlerësuar dokumentacionin dhe të gjitha kriteret ligjore që parashikon legjislacioni për investimet strategjike, përkatësisht VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit”. Vetë AIDA, në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, Neni 13/dh, parashikon se subjekti aplikues, përveç të tjerash, dorëzon tek AIDA ‘autorizimin mbi dakordësinë e investitorit për publikimin e detajeve të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë’. Kjo dispozitë e veçantë zërthehet më gjerë në VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 ‘Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike’ ku në Kreun I, pika 4/gj, parashikohet shprehimisht se: Dokumentacioni që dorëzohet duhet të përfshijë detyrimisht pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë, të përcaktuara, shprehimisht, nga subjekti i interesuar’. Për sa më lart, në dosjen e administruar përfshihet deklarata e subjektit aplikues mbi të dhënat apo dokumentacionin në dosje që përcaktohet shprehimisht nga subjekti si konfidencial. Në të tilla kushte, në pamundësi	
--	--	---	--	--	--

				për të cenuar marrëveshjen me subjektin aplikues, por për të ezauruar çdo shqetësim tuajin lidhur me procedurën e ndjekur, ne mbetemi në dispozicionin Tuaj, kurdo që ju e keni të mundur të vini pranë zyrave të AIDA, për të konsultuar dosjen aplikuese ashtu si dhe për të marrë të gjitha shpjegimet e nevojshme mbi çdo dokumentacion të dorëzuar dhe shqyrtuar të projekteve të investimit.		
9	05.05.2025	Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar, emisioni “Vetting” kërkon si informacion: 1. Kopje të ekstraktit të pronarit përfitues të kompanisë [REDAKTUAR] dhe pronar përfitues [REDAKTUAR] të dorëzuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve me të dhënat sipas modelit të Qendrës Kombëtare të	09.05.2025	Në vijim të kërkesës suaj Nr. 2505/056 date 05.05.2025, kerkese e dyte kjo lidhur me subjektin [REDAKTUAR] ju bejme me dije si me poshte vijon: Përveç sa ju kemi informuar ne komunikimin e mëparshëm, ju bejme me dije se subjekti aplikues ne kohen që ka dorëzuar pranë AIDA dokumentacionin për vlerësim për statusin “Projekt me Potencial Strategjik” ka vene ne dispozicion te Grupi Operacional dokumentacion përtej kërkesave që parashikon VKM Nr. 1024/2015. Ne shkresën tuaj kerkoni që tju vihet ne dispozicion kopja e ekstraktit të pronarit përfitues me të dhëna sipas modelit të QKB dhe ligjit Nr. 122/2020 i ndryshuar për regjistrimin e pronarit përfitues. Referuar këtij të fundit autoritet kompetente shtetërore në zbatim të tij parashikohen shprehimisht në Neni 3, pika 7. Ju bejme me dije se edhe pse pranë AIDA administrohet dokument ku pasqyrohet struktura administrative e shoqërisë në kohen e aplikimit, si dhe ekstrakti i regjistrimit të	E plotë	Nuk ka

		Biznesit dhe ligjit për Regjistrimin e Pronarëve Përfitues për miratimin e statusit “Projekt me Potencial Strategjik [REDACTED] 2. Planin e biznesit për projektin e dorëzuar nga [REDACTED] me numër nipti [REDACTED] për miratimin e statusit “Projekt me Potencial Strategjik “Parku i [REDACTED]	shoqerine prane QKB, ky dokument nuk mund te te behet publik nga momenti qe institucioni kompetent QKB ende nuk ka realizuar regjistrimin dhe publikimin e te dhenave te detyrueshme te pronarit perfitues fundor te subjektit ne fjale. Per aq sa jemi ne dijeni, subjekti prej 3 vitesh ka dorezuar disa aplikime prane QKB, i fundit i ketij lloji eshte dorezuar ne prill te ketij viti (kopje e ketij dokumentacioni administrohet edhe prane AIDA). Sugjerojme qe mbi cdo kerkese mbi kete dokumentacion apo arsyet e refuzimit te aplikimit te kontaktoni strukturen kompetente QKB, pasi eshte institucioni pergjegjes per te vleresuar dokumentacionin perkates te dorezuar per cdo subjekt perberes te kompanise [REDACTED] Gjithashtu edhe AIDA eshte ne pritje te perfundimit te ketij procesi nga QKB. Sa i perket kerkeses suaj mbi planin e biznesit, ashtu sikurse ju informuar ne pergjigjen e meparshme, në dosjen e administruar përfshihet deklarata e subjektit aplikues mbi të dhënat apo dokumentacionin në dosje që përcaktohet shprehimisht nga subjekti si konfidencial. Në të tilla kushte, në pamundësi për të cenuar marrëveshjen me subjektin aplikues, por për të ezauruar çdo shqetësim tuajin lidhur me procedurën e ndjekur, ne mbetemi në dispozicionin Tuaj, kurdo që ju e keni të mundur të vini pranë zyrave të AIDA, për të konsultuar dosjen aplikuese ashtu si dhe për të marrë të gjitha shpjegimet e nevojshme mbi çdo	
--	--	--	---	--

				dokumentacion të dorëzuar dhe shqyrtuar të projekteve të investimit.		
9.	12.06.2025	Ne baze dhe zbatim të ligj Nr. 119/2014 i ndryshuar, po ju dergoj kërkesat me poshte: 1. Nje kopje te praktikws se vendimit te KIS [REDACTED] 2. Kopje te tere memove te brendshme te AIDA ne lidhje me kete vendim 3. A ka verifikuar AIDA plotesimin e kriterave financiare (si psh fizibilitet, plan biznesi, disponueshmerine e kapaciteve financiare) ne momentin e nderrimit te kuotave te aksionereve te kesaj shoqerie ne zbatim me VKM 1026/2015? 4. A ka verifikuar AIDA plotesimin e kriterave te VKM 1026/2015 ne momentin e nderrimit te kuotave te	16.06.2025	Në vijim të shkresës “Kërkesë për Informacion në bazë të ligjit 119/2014” protokolluar pranë AIDA me Nr. 1347 Prot., datë 16.06.2025, lidhur me projektin e investimit [REDACTED] ju informojmë si më poshtë vijon: Procedura që ndiqet për investimet strategjike bazohet në një legjislacion të posaçëm, përkatësisht: • Ligj nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe • VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015; • VKM Nr. 1024, datë 16.12.2015; • VKM Nr. 1025, datë 16.12.2015; • VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015; • VKM Nr. 1027, datë 16.12.2015; • VKM Nr. 1028, datë 16.12.2015; • VKM Nr. 1029, datë 16.12.2015; • VKM Nr. 1030, datë 16.12.2015; • VKM Nr. 1031, datë 16.12.2015; • VKM Nr.1032, datë 16.12.2015. Në bazë dhe zbatim të këtij legjislacioni të posaçëm, AIDA ka tre misione: • Dritare Unike për investitorët dhe projektet; • Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike; • Agjent Asistues i subjektit dhe/ose projektit që ka përfituar status strategjik. Legjislacioni i investimeve strategjike përcakton kriteret kualifikuese dhe udhëzon procedurën që ndiqet për vlerësimin e një projekti investimi dhe subjektit propozues, ndërkohë nuk i mbivendoset	E plotë	Nuk ka

		aksionereve te kesaj shoqerie? 5. A ka njoftuar shoqeria [REDACTED] ne AIDA per nderrimin e kuotave te aksionereve?	legjislacioneve sektoriale, në bazë dhe zbatim të të cilave bazohet realizimi i cdo projekti investimi. Referuar në sa më sipër, shkurtimisht ju bëjmë me dije se AIDA koordinon një proces vlerësimi të projekteve potenciale të investimit, proces i cili realizohet nga Grupi Operacional. Ky i fundit është një strukturë e përbërë nga përfaqësues të institucioneve të përfshira në vlerësim, të cilët analizojnë dhe rekomandojnë çështjet nën kompetencë. Organi kolegjal vendimmarrës është vetëm Komiteti i Investimeve Strategjike. Lista shtruese e dokumentacionit që dorëzohet nga subjektet për të aplikuar për statusin strategjik parashikohet në pikën 4, të Kreut 1 të VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015. Ky dokumentacion dorëzohet nga çdo subjekt aplikues, i cili ka interes të kualifikohet. Referuar rastit konkret, subjekti aplikues [REDACTED] ka dorëzuar listën e plotë të dokumentacionit të parashikuar në legjislacion dhe pasi ky dokumentacion ka ndjekur të gjithë ciklin e plotë të vlerësimit, ka përfituar vendimmarrjen pozitive të KIS nëpërmjet [REDACTED]. Ky status u miratua me një afat 4 vjeçar. Pas vendimit të KIS bazuar në nenin 7, pika c dhe nenit 10 të VKIS të sipërcituar, Këshilli i Ministrave vlerësoi miratimin e [REDACTED]. Ndërkohë, përgjatë procesit të negocimit të kontratës për përdorimin e pronës, subjekti [REDACTED] shpk ka ndryshuar strukturën menaxheriale duke e përcjellë këtë ndryshim me shkresë zyrtare protokolluar pranë AIDA me Nr. 29/7 prot., datë 14.09.2023. Referuar strukturës së mëparshme	
--	--	---	--	--

				menaxheriale financimi i projektit do të realizohej nga tre subjektet që përbënin shoqërinë ■■■, në përputhje me përqindjen e kuotave që secila nga këto shoqëri zotëronte shoqërinë ■■■ (përbërja e shoqërisë ■■■ është informacion i aksesueshëm në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licensave). Sipas strukturës së re menaxheriale financimi i projektit do të realizohej nga ortakut i vetëm i saj, mbështetur edhe me letër interesi nga një bankë e nivelit të dytë, për të suportuar nevojat financiare të shoqërisë deri në 10% të vlerës totale të investimit. Theksojmë këtu se, dokumentacioni financiar që shoqëron dokumentacionin aplikues bazohet në parashikimet e VKM Nr. 1028, datë 16.12.2015. Ky ndryshim në strukturën menaxheriale është ilustruar me dokumentacion respektiv dhe është marrë në konsideratë nga autoriteti kompetent, i cili ka propozuar vendimin respektiv në Këshillin e Ministrave. Referuar në sa më sipër, të gjitha vendimmarrjet lidhur me këtë projekt investimi, apo ndryshimet brenda strukturës së shoqërisë janë informacione publike të aksesueshme lehtësisht. Ndërkohë, sa i përket kërkesës suaj për vënë në dispozicionin tuaj kopje të praktikës së vendimit (që referuar procedurës që ne ndjekim, do të thotë lista me dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti) dhe memove të brendshme (që referuar procedurës që ne ndjekim do të thotë rekomandimet teknike nga çdo institucion i përfshirë në vendimmarrje) ju bëjmë me dije se këto janë materiale që nuk mund t'ju vihen në dispozicion për sa kohë trajtojnë të dhëna sensitive të subjekteve aplikues.		
--	--	--	--	--	--	--

				Në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, Neni 13/dh, parashikohet shprehimisht se subjekti aplikues, përveç të tjerash, dorëzon tek AIDA <i>‘autorizimin mbi dakordësinë e investitorit për publikimin e detajeve të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë’</i>. Kjo dispozitë e veçantë zërthehet më gjerë në VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 ‘Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike’ ku në Kreun I, pika 4/gj, parashikohet shprehimisht se <i>‘Dokumentacioni që dorëzohet duhet të përfshijë detyrimisht pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë, të përcaktuara, shprehimisht, nga subjekti i interesuar’</i>. Për sa më lart, në dosjen e administruar përfshihet deklarata e subjektit aplikues mbi të dhënat apo dokumentacionin në dosje që përcaktohet shprehimisht nga subjekti si konfidencial. Në të tilla kushte, në pamundësi për të cenuar marrëveshjen me subjektin aplikues, por për të ezauruar çdo shqetësim tuajin lidhur me procedurën e ndjekur, ne mbetemi në dispozicionin Tuaj, kurdo që ju e keni të mundur të vini pranë zyrave të AIDA, për të konsultuar dosjen aplikuese ashtu si dhe për të marrë të gjitha shpjegimet e nevojshme mbi çdo dokumentacion të dorëzuar dhe shqyrtuar të projekteve të investimit.		
10	23.06.2025	Të nderuar drejtues të AIDA-s, [REDACTED]	25.06.2025	Në vjiiim të shkresës suaj., datë 23.06.2025 me lëndë “Kërkesë për Informacion dhe vënie në	E plotë	Nuk ka

		[REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ju lutet institucionit tuaj për vënie në dispozicion të dokumenteve/informacioneve zyrtare në lidhje me ecurinë e marrëveshjes së investimit me kompaninë që përfaqëson [REDAKTUAR] Më konkretisht: Sipas vendimit të miratuar nga qeveria shqiptare në janar 2025, pas dhënies së statusit të investitorit strategjik, parashikohej ngritja e një grupi negociator ndërinstitucional për të arritur një marrëveshje investimi, ku do të përcaktoheshin kushtet, përfshirja dhe roli i shtetit shqiptar. Për sa më sipër, ju lutem më vini në dispozicion	dispozicion dokumentacioni” protokolluar pranë AIDA me Nr. 1381 Prot., datë 23.06.2025 ju informojmë si më poshtë vijon: Referuar parashikimeve të pikës 14 të vendimit [REDAKTUAR] si dhe me Urdhër të Kryetarit të KIS [REDAKTUAR] është ngritur Grupit të Negocimit të Marrëveshjes (GNM) në përbërje përfaqësues nga: - Korporata Shqiptare e Investimeve (AIC), - Aparati i Zëvendëskryeministrit, - Aparati i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, - Aparati i Ministrisë së Financave, - Aparati i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, - Albanian Seaports Development Company sh.a, - Agjencia Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Detyrat e këtij grupi janë ato të caktuara në Vendimin e KIS, ashtu sikundër në vendim janë qartazi të ndara detyrat për të gjitha strukturat e përfshira në mënyrë direkte dhe indirekte në vlerësimin e projektit të investimit. Aktualisht, GNM është në proces negociimi me subjektin propozues të këtij investimi.		
--	--	---	--	--	--

		informacionin në vijim: A është ngritur grupi negociator? Cilat institucione përfaqësohen në të? 1. A është nënshkruar një marrëveshje investimi me kompaninë përkatëse? Nëse po, ju lutem të na dërgoni një kopje të saj ose një përmbledhje të dispozitave kryesore që nuk bien ndesh me parimin e mbrojtjes së sekreteve tregtare. 2. A është përfshirë shteti shqiptar në këtë projekt përmes formës së partneritetit publik-privat (PPP), marrëveshjeje koncesionare apo ndonjë tjetër mekanizëm ligjor? 3. A është kryer vlerësimi i ndikimit mjedisor për projektin dhe cila është ecuria e procedurave planifikuese në zonën e [REDACTED]		Çdo konkluzion i kësaj negociate do jetë informacion publik, lehtësisht i aksesueshëm.		
--	--	--	--	---	--	--

		Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetem në pritje të përgjigjes suaj!				
11	Prane AIDA kerkesa eshte percjelle me email me date 26.06.2025	Ju lutem, vini në dispozicion një kopje të plotë të marrëveshjes së bashkëpunimit apo koncesionit të firmosur për projektin e zhvillimit të portit të Durrësit. • A ekziston një studim fizibiliteti, ekonomik dhe mjedisor për këtë projekt? Nëse po, kërkojmë të kemi akses në këtë dokument. • A është zhvilluar ndonjë konkurs publik ndërkombëtar për përzgjedhjen e këtij projekti dhe partnerit investues? • Nëse jo, mbi çfarë kriteresh është përzgjedhur partneri? • Cilat kompani kanë shprehur interes	01.07.2025	Në vjiim të shkresës suaj datë 20.05.2025 me lëndë “Kërkesë për Informacion dhe vënie në dispozicion dokumentacioni”, e cila është deleguar pranë AIDA me email dhe protokolluar pranë institucionit tonë me Nr. 1396 Prot., datë 26.06.2025 ju informojmë si më poshtë vijon: Me vendimin nr. 949, datë 25.11.2015, Këshilli i Ministrave ka miratuar marrëveshjen mes tij dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA) për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, ku neni 3, pika 1, i të cilit ka përcaktuar nxitjen dhe krijimin nga secila palë të kushteve të favorshme për investitorët e palës tjetër kontraktuese për kryerjen e investimeve në territorin e saj, si dhe pranimin e këtyre investimeve në përputhje me ligjet e rregulloret e saj. Me ligjin nr. 145/2020, datë 3.12.2020 (ligji nr. 145/2020), Kuvendi ka ratifikuar marrëveshjen “Për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji, pjesë përbërëse e tij. Neni 6 i marrëveshjes ka përcaktuar, ndër të tjera, listën e projekteve specifike që konsiderohen të një natyre strategjike në përmbushjen e objektivave të kësaj marrëveshjeje dhe marrëveshjeve të mëparshme ekonomike e të bashkëpunimit midis dy palëve, konkretisht: rihvillimi i Portit të Durrësit; mundësitë e investimeve në industrinë e turizmit, bujqësisë dhe logjistikës në Vlorë, Sarandë dhe Ksamil;	E plotë	Nuk ka

		zyrtarisht për zhvillimin e portit? • Sa është pjesa e fitimit që i kalon shtetit shqiptar nga ky projekt? • A është realizuar një vlerësim i ndikimit në trashëgiminë kulturore dhe urbane të qytetit të Durrësit?	investimet në fushën e turizmit në zonën e Përmetit. Po sipas këtij neni, kontratat, programet dhe projektet strategjike të rëna dakord, në përputhje me këtë marrëveshje, nuk do të jenë në asnjë prej palëve që u nënshtrohen prokurimit publik, tenderit publik, procedurës konkurruese publike ose ndonjë procedure tjetër të përcaktuar në legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë ose të EBA-së pas ratifikimit të saj. Procedurat e ndjekura për hartimin e akteve të sipërpërmendur nuk kanë ndjekur dhe trajtuar nga AIDA. Ndërkohë, në vijim të marrëveshjes së miratuar me ligjin nr. 145/2020 dhe në zbatim të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë” (ligji për investimet strategjike), vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 1023, datë 16.12.2015, “Për nënsektorët strategjikë dhe zonat me përparësi zhvillimi” e nr. 1026, datë 16.12.2015, “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, si dhe vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 14.10.2020, “Për miratimin e planit kombëtar sektorial të transportit detar dhe infrastrukturës portuale”, me vendimin nr. 14/6, datë 2.12.2021 (vendimi nr. 14/6), Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS), ka vendosur miratimin e statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” për projektin e investimit [REDACTED] si një projekt i integruar turistik dhe i një rëndësie strategjike për vendin, të kushtëzuar me realizimin e detyrave, planit të veprimit të parashikuar në këtë vendim, si dhe me finalizimin e një marrëveshjeje për formën e bashkëpunimit midis palëve, të vlefshme sipas parashikimeve ligjore të zbatueshme.	
--	--	---	--	--

				Me VKM nr. 861, datë 29.12.2021, “Për transferimin në fondin e pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike, të pronave të paluajtshme shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik [REDACTED] dhe për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Autoriteti Portual Durrës tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë” (VKM nr. 861/2021), Këshilli i Ministrave ka vendosur transferimin në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS), të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës, me sipërfaqe totale 80.9 ha. Me vendimin nr. 494, datë 21.7.2022 (VKM nr. 494/2022), Këshilli i Ministrave ka bërë disa ndryshime në VKM-në nr. 861/2021. Me ligjin nr. 79/2022, datë 24.11.2022 (ligji nr. 79/2022), Kuvendi ka miratuar marrëveshjen kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe EHRED, ASDC e NSHMI për projektin e investimit strategjik [REDACTED] të cilën mund ta aksesoni në link: https://asdc.al/ep-content/uploads/2023/12/LIGJI-NR.79_2022_-PER-MIRATIMIN-E-MARREVESHJES-KUADER.pdf Në këtë marrëveshje mund të gjeni përgjigjen e pyetjes suaj rreth pjesës së fitimit që i kalon shtetit shqiptar nga ky projekt. Në vijim, me vendimin nr. 115, datë 1.3.2023 (VKM nr. 115/2023), Këshilli i Ministrave ka vendosur transferimin në pronësi të ASDC-së së pronave të paluajtshme shtetërore, pjesë e FPPMIS-së, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “ [REDACTED] me	
--	--	--	--	--	--

				vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8514, Bashkia Durrës. Për sa i takon dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti në kohën e aplikimit për përfitimin e statusit strategjik sjellim në vëmendjen tuaj se AIDA ka vlerësuar dokumentacionin dhe të gjitha kriteret ligjore që parashikon legjislacioni për investimet strategjike, përkatësisht VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit”. Vetë AIDA, në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, Neni 13/dh, parashikon se subjekti aplikues, përveç të tjerash, dorëzon tek AIDA ‘autorizimin mbi dakordësinë e investitorit për publikimin e detajeve të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë’. Kjo dispozitë e veçantë zërthehet më gjerë në VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 ‘Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike’ ku në Kreun I, pika 4/gj, parashikohet shprehimisht se: Dokumentacioni që dorëzohet duhet të përfshijë detyrimisht pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t’u shfaqen personave të tretë, të përcaktuara, shprehimisht, nga subjekti i interesuar’. Për sa më lart, në dosjen e administruar përfshihet deklarata e subjektit aplikues mbi të dhënat apo dokumentacionin në dosje që përcaktohet shprehimisht nga subjekti si konfidencial. Në të tilla kushte, në pamundësi për të cenuar marrëveshjen me subjektin aplikues, por për të ezauruar çdo shqetësim tuajin lidhur me procedurën e ndjekur, ne		
--	--	--	--	--	--	--

				mbetemi në dispozicionin Tuaj, kurdo që ju e keni të mundur të vini pranë zyrave të AIDA, për të konsultuar dosjen aplikuese ashtu si dhe për të marrë të gjitha shpjegimet e nevojshme mbi çdo dokumentacion të dorëzuar dhe shqyrtuar të projekteve të investimit. Përsa i takon, pyetjes suaj lidhur me vlerësimin e ndikimit të projektit në trashëgiminë kulturore dhe urbane të qytetit të Durrësit, ju bëjmë me dije se gjurma e projektit në fjalë ndodhet jashtë kufirit të zonës Arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit, miratuar me VKM Nr. 786 datë 26.12.2018. Në zbatim të pikës 1 të nenit 134, të ligj Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” për rastin në fjalë subjekti duhet të disponojë miratim për projektin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale. Aktualisht, subjekti në zbatim të legjislacionit në fuqi disponon leje zhvillimore miratuar me Vendimin Nr. 04, datë 29.05.2023 të KKTU dhe leje ndërtimi miratuar me vendimin Nr. 15 datë 25.01.2025 të KKTU.		
12.	Prane AIDA kërkesa është përcjellë me email më datë 03.07.2025	Ne jemi duke mbledhur të dhëna mbi investimet e miratuara me statusin “investitor strategjik” dhe ju drejtohem për informacion dhe dokumentacion mbi çështjet e mëposhtme: Konkretisht, kërkojmë:	09.07.2025	Në lidhje me pyetjen 1 dhe 2 ju informojmë se i gjithë informacioni mbi investimet e miratuara/mosmiratuara; subjektet propozues/ID tregtar i tyre; vlerat e investimit/punësimi; sektorët që i përkasin projektet e investimit dhe ashtu si dhe informacione të tjera, i gjeni lehtësisht të aksesueshme në këtë link: https://aida.gov.al/investimet-ne-shqiperi/strategjike/komiteti-investimeve-strategjike-kis/ Sa i përket pyetjes 3 dhe 4, ju bëjmë me dije se në referencë të nenit 19 të ligjit të Nr. 55/2015 “Për	E plotë	Nuk ka

		•Sa prej investimeve të miratuara me status “investitor strategjik” janë investime të huaja direkte? •Si ndahen investimet strategjike sipas sektorëve? Ju lutemi të na dërgoni një ndarje të projekteve sipas sektorëve përkatës (turizëm, bujqësi, energji, teknologji, etj.). •Në sa raste AIDA ka nisur procedurë për rishikimin e statusit të investitorit strategjik, bazuar në dispozitat ligjore që parashikojnë revokimin kur konstatohet se projekti ka dhëna të pavërteta apo ka ndryshime të të dhënave të dala rishtazi? •Ju lutemi të referoni subjektet që janë aktualisht nën shqyrtim për revokim, nëse ka të tillë. •Të dhënat apo regjistrin e		investimet strategjike ne RSH” i ndryshuar parashikohet “Pezullimi i përkohshëm, anulimi dhe shfuqizimi i vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike”. Deri më tani pranë Sekretariatit Teknik të KIS, AIDA, nuk ka asnjë rast të referuar ku autoriteti publik përgjegjës për monitorimin e një projekti investimi të jetë ndodhur përballë kushteve të parashikuara e vertetuara në këtë dispozitë. Gjithashtu, ju informojmë se afati i statusit strategjik për çdo projekt investimi është i limituar në kohë. Ky afat është i shënuar në çdo vendimmarrje të KIS. Ashtu si edhe për një projekt investimi mund të ketë një apo disa vendimmarrje të KIS. Sa i përket pyetjes së 5, ju informojmë se KIS në çdo rast miraton të drejtën për akses në infrastrukturë mbështetëse dhe jo mbulimin e kostove për të. Çka do të thotë që një subjekti që i miratohet e drejta e për infrastrukturës mbështetëse për projekt propozimin e tij, jetëzimi i kësaj infrastrukture do të bazohet në legjislacionet sektoriale sipas kostove respektive. Gjithashtu, nëpërmjet ligjit të investimeve strategjike nuk janë miratuar asnjëherë subvencione apo mbështetje financiare për subjekte private. Vetëm për projektin “Marina dhe Jahtet e Durrësit”, për të cilin çështja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja dhe kontributi i strehimit social, janë rregulluar sipas një regjimi specifik të miratuar me ligj të veçantë. Ndërkohë, ky projekt investimi do të bashkëzhvillohet nëpërmjet një Joint – Venture me shtetin shqiptar.	
--	--	---	--	--	--

		përfitimeve që investorët strategjikë kanë marrë nga viti 2016 deri tani në kuadër të përfitimit të këtij statusi, duke përfshirë: oVlerën financiare të mbështetjes në procedura (lehtësira, përjashtime, subvencione apo mbështetje të tjera financiare). oVlerën financiare të mbështetjes në infrastrukturë (ndërtime rrugësh, ujësjellës, kanalizime, energji, porte, etj.). oJu lutemi që informacioni të na vihet në dispozicion në formë të plotë dhe të detajuar, në përputhje me praktikën tuaj të brendshme dhe detyrimet ligjore.				
--	--	---	--	--	--	--